

NJOFTIM URGJENT PËR NJË SULM DHE DËBIM TË AFËRT TË PROSFYGIKA NË AVENUNË ALEXANDRAS

MBËSHTET – PËRHAP – REZISTO

Gjatë verës së vitit 2025, në mënyrë të fshehtë, Rajoni Policis I Atikës, përmes një marrëveshjeje programatike, nisi planifikimin e represionit dhe dëbimit të Komunitetit Prosfigjika (squatt) në Avenunë Alexandras.

Me fillimin e vitit 2026, u vu në lëvizje një fazë e re e këtij plani, duke përdorur artikuj të paguar nga zëdhënës të qeverisë dhe duke promovuar të gjitha hapat që parashikojnë dëbimin e dhunshëm të Komunitetit të Prosfigjika brenda gjashtë muajve të ardhshëm duke e shoqë atë në një festë me para publike.

Gjatë dekadës së fundit, kjo është hera e katërt që shteti dhe qeveria kanë tentuar të dëbojnë dhe të plaçkisin Prosfigjikat. Këtë herë përpjekja duket më seriozja dhe është gati të zbatohet menjëherë. Të gjitha treguesit tregojnë se ekziston një plan që parashikon si financimin e projektit me një kosto totale të vlerësuar prej 15 milionë eurosh, nga fondet evropiane të Programit Rajonal ESPA Atika 2021–2027 ashtu edhe, në nivel propagande, krijimin e supozuar të banesave sociale dhe bujtinave për të afërmit e pacientëve të Spitalit Onkologjik “Agios Savvas”, duke u përpjekur të shfrytëzojnë ndjeshmëritë dhe refleksionet shoqërore.

Nuk do t’ia dalin, as këtë herë!

Prosfigjika përbën një Komunitet me më shumë se 400 persona grekë, refugjatë dhe migrantë përfshirë 50 fëmijë, grupe shoqërore të cënueshme, persona me probleme serioze të shëndetit mendor, pacientë me kancer, të moshuar etj.

Gjatë 16 viteve të funksionimit të tij, pikat e shitjes dhe prodhimit të drogës, përfshirë drogat e rënda që kishin pllakosur zonën me tolerancën e GADA-s (Drejtoria e Policisë së Athinës), janë eliminuar, dhe janë krijuar 22 struktura autonome të vetë-mjaftueshmërisë sociale, përfitimit dhe vetë-organizimit për banorët e Komunitetit dhe zonat më të gjera të Ambelokipit dhe Gkizit. Në mënyrë treguese, i përmendim:

- Shtëpia e Fëmijëve dhe Struktura e Vetë-Edukimit, si dhe Kopshti I Vetë-Organizuar, që funksionojnë çdo ditë me një program të plotë arsimor për fëmijët e Komunitetit të Profigjia dhe të lagjes më të gjerë, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me shkollat, shoqatat e prindërve dhe sindikatat e mësuesve në lagjen Ambelokipi, në të gjithë Atikën dhe në nivel kombëtar.
- Struktura Shëndetësore dhe Farmacia Sociale, që ofrojnë kujdes për banorët e lagjes që janë në nevojë, në bashkëpunim me dhjetëra struktura shëndetësore të vetë-organizuara, klinika sociale dhe sindikata të punonjësve të shëndetësisë në nivel panhelenik.
- Struktura e Strehimit për Pacientët dhe Shoqëruesit e tyre nga Spitali Onkologjik "Agios Savvas", në bashkëpunim me shoqatën e punonjësve të spitalit.
- Furra Kolektive "Berkin Elvan", e cila prodhon çdo ditë bukë dhe produkte furre për banorët e lagjes dhe për gjithë Athinën.
- Struktura e Punimeve Teknike, përgjegjëse për mirëmbajtjen e vazhdueshme të ndërtesave të Profigjikës.
- Struktura Kolektive e Kafenesë dhe Kinemasë për fëmijë dhe të rritur, që ofron argëtim dhe kontribuon në zhvillimin kulturor të banorëve të lagjes dhe të Athinës më gjerë.
- Qendra Sociale, e cila strehon asamblenë e përgjithshme javore të Komunitetit për marrjen e vendimeve, si dhe Bibliotekën e Lagjes dhe Sallën e Leximit. Me kalimin e viteve, ajo ka pritur dhjetëra aktivitete, prezantime dhe asamble me karakter shoqëror, politik dhe kulturor, si të Komunitetit ashtu edhe të grupeve dhe kolektivave të tjera shoqërore.
- Struktura e Grave, që synon kolektivizimin dhe fuqizimin e grave dhe personave gjinorë të larmishëm, krijimin dhe përhapjen e një kulture kundër sistemit patriarkal, dhe që funksionon gjithashtu si strehë emergjente për gratë dhe personat gjinorë të larmishëm në nevojë.

- Skuadra e Solidaritetit, e strehuar brenda infrastrukturës së Komunitetit, e cila ofron ushqim pesë ditë në javë për dhjetëra persona në qendër të Athinës.

Të gjitha strukturat e Komunitetit janë të hapura për të gjithë dhe funksionojnë mbi bazën e vetë-organizimit dhe solidaritetit shoqëror.

Që gjatë vitit të kaluar, Komuniteti ka shpallur publikisht vendimin e tij për të realizuar restaurimin e jashtëm të ndërtesave të Prosfigjikas, përmes vetë-financimit dhe me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e arkitektëve, inxhinierëve civilë dhe specialistëve të tjerë teknikë. Plani i Rajonit përbën një kundërpërgjigje që synon të parandalojë këtë iniciativë shoqërore, me qëllim për të vënë dorë mbi fondet publike.

Kjo përpjekje e re nga ana e Rajonit përbën një direktivë dhe vendim politik qendror të regjimit Mitsotakis për të çmontuar projektin më të madh shoqëror që ekziston aktualisht brenda indit urban të Athinës dhe në nivel kombëtar si dhe një nga më të mëdhenjtë në Evropë, i cili ka tërhequr vëmendjen dhe interesin e universiteteve dhe institucioneve kulturore e arsimore në Greqi dhe jashtë saj.

Përtej karakterit të tij shoqëror, Komuniteti Prosfigjika ka qenë vazhdimisht në vijën e parë të betejave shoqërore, politike, klasore dhe internacionaliste. Luftëtarë nga Greqia, Evropa dhe organizata revolucionare nga Turqia dhe Kurdistan jetojnë gjithashtu brenda Komunitetit. Regjimi Mitsotakis e sheh Prosfigjikën si një kundërshtar politik që kërkon ta shkatërrojë, por edhe si një aset ekonomik që ëndërron ta plaçkitë dhe shfrytëzojë.

Ky është një vendim politik që, pas gënjeshtreve për “zhvillimin e lagjes”, synon dëbimin e njerëzve dhe shkatërrimin e modeleve shoqërore të vetë-organizimit dhe kontributit social. Është e qartë se, ndër të tjera, kjo është edhe një tjetër manovër parazgjedhore e një qeverie në rënie, produkti i vetëm i së cilës ka mbetur doktrina e “ligjit dhe rendit”.

- Ata gënjejnë kur pretendojnë se Rajoni interesohet për strehimin social. Prosfigjika tashmë përbëjnë strehim social për qindra njerëz që kriza i ka shtyrë në rrugë dhe që kolapsi i të gjitha strukturave shoqërore i ka zhytur në mjerim dhe marginalizim. Plani i tyre për të hedhur mbi 400 persona në rrugë për të strehuar 50 “të tyret” është kulmi i hipokrizisë

dhe çnjëzësisë së një sistemi që kujdeset vetëm për fitimin e vet dhe plaçkitjen e fondeve publike dhe evropiane. Është një justifikim i turpshëm për të grabitur strehimin social ekzistues në emër të strehimit të ri social, ndërkohë që 80.000 apartamente bosh në pronësi të Bashkisë së Athinës mbeten të pashfrytëzuara në qendër të qytetit.

- Ata gënjejnë kur pretendojnë se Rajoni kujdeset për të afërmit e pacientëve me kancer, të cilët Komuniteti i ka strehuar dhe mbështetur për vite me radhë, njerëz që shpesh flenë në makinat e tyre për ditë ose javë të tëra ndërsa të afërmit e tyre i nënshtrohen trajtimeve afatgjata. Komuniteti tashmë ofron kushte të shëndetshme jetese dhe mbështetje përmes punës dhe burimeve të veta. Rajoni planifikon të hedhë në rrugë të afërmit e pacientëve me kancer, ndërsa njëkohësisht ndërton marrëdhënie klienteliste me njerëz në nevojë. Në të njëjtën kohë, prona të panumërta në pronësi të shtetit dhe të Kishës ndodhen vetëm disa blloqe larg lagjes Prosfigjika.
- Ata gënjejnë kur pretendojnë se Rajoni kujdeset për çështjet shoqërore të lagjes, kur Prosfigjika përbëjnë një shembull të bashkëjetesës harmonike të njerëzve nga e gjithë bota 27 kombësi të ndryshme me gjuhë, kultura dhe fe përkatëse. Është e vetmja lagje ngjitur me një njësi të OKANA-s (Organizata për Trajtimin e Varësisë nga Droga) që nuk ka pika të tregtimit të drogës. I vetmi problem i sigurisë publike në zonë janë politikat e GADA-s dhe Ministrisë së Rendit Publik, të cilat periodikisht pushtojnë lagjen me gaz lotsjellës pranë dy spitaleve për të goditur një Komunitet të vetë-organizuar që promovon një model të ndryshëm të barazisë dhe drejtësisë shoqërore.
- Ata gënjejnë kur pretendojnë se kujdesen për shfrytëzimin e lagjes Prosfigjika dhe zhvillimin e Ambelokipit. "Rizhvillimi" i Prosfigjikas do të shkaktojë rritje të menjëhershme të qirave dhe kostos së jetesës në të gjithë zonën, duke dëbuar me forcë dhjetëra dhe qindra banorë që nuk mund të përballojnë çmimet në rritje. Kjo situatë do të prekë gradualisht të gjitha zonat përreth, duke ndryshuar përbërjen shoqërore përmes zëvendësimit të banorëve ekzistues me shtresa më të pasura.

I bëjmë thirrje çdo njeriu me ndërgjegje dhe empati të qëndrojë përkrah Komunitetit të Prosfigjikës kundër planeve për dëbimin dhe plaçkitjen e kësaj lagjeje historike të rezistencës, vetë-organizimit dhe strehës.

I bëjmë thirrje të gjithëve të mobilizohen dhe ta përcjellin këtë luftë në lagjet e tyre, në rrethet familjare e shoqërore, në shkolla, sindikata dhe vende pune, për të mbrojtur Prosfijjikat nga planet grabitqare të mashtruesve të mëdhenj qeveritarë.

Ata që nuk u kujdesën për jetët e 57 njerëzve në tren.

Ata që e kanë kthyer Greqinë në koshin e plehrave të Evropës.

Ata që kanë çmontuar çdo strukturë shoqërore dhe çdo shërbim publik të shëndetësisë, arsimit, strehimit dhe kulturës.

Ata që lanë kaq shumë njerëz të vdesin gjatë COVID-it.

Ata që i kanë kthyer fermerët dhe fshatin në lypës.

Ata që kanë dëbuar gjysmë milioni të rinj nga vendi gjatë dekadës së fundit.

Asnjëri prej tyre nuk meriton asnjë besim në lidhje me Prosfijjikan, dhe të gjithë duhet të njohin planet e ndyra që fshihen pas fjalëve të tyre.

Dëbimi dhe represioni ndaj Prosfijjikas do të kenë pasoja të pallogaritshme për shëndetin mendor dhe fizik të dhjetëra fëmijëve, të moshuarve dhe pacientëve të Komunitetit. Shumë prej tyre nuk do të jenë gjallë një vit pas dëbimit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë të qeverisë dhe agjentëve të saj.

Dëbimi dhe represioni i Banesave të Refugjatëve do të godasë gjithashtu lëvizjen dhe të gjitha luftërat në zhvillim, pasi çdo hapësirë e çliruar që humbet është një goditje ndaj luftës së përbashkët kundër shfrytëzimit dhe padrejtësisë që përjeton pothuajse e gjithë shoqëria.

Nga ana jonë, kemi një përgjegjësi dhe një detyrë për të mbrojtur shtëpitë që i kemi kujdesur me vetëmohim për vite me radhë, sikur të ishin tonat, duke mbajtur gjallë një monument kombëtar dhe arkitekturor që planifikimi shtetëror do ta kishte lënë të shembej për të përfituar nga rindërtimi i tij. Kemi një përgjegjësi dhe një detyrë për të mbrojtur njerëzit e Komunitetit tonë, të cilët përndryshe do të përfundonin duke fjetur në kartonë, në uri dhe mjerim.

Deklarojmë publikisht se nuk do t'i lëshojmë asnjë centimetër tokë regjimit dhe kompanive të tij dhe se do të luftojmë me të gjithë forcën tonë për t'i anuluar në praktikë planet e tyre të ndyra edhe me jetët tona. Kemi një detyrë historike dhe shoqërore për të luftuar dhe për të vazhduar.

Do të sigurojmë që kostoja e madhe që jemi të detyruar të përballojmë për të mbrojtur lagjen dhe Komunitetin tonë të jetë edhe më e madhe për qeverinë dhe agjentët e saj.

NËSE BIEM, DO TË BIEM MBI KOKAT E TYRE

I bëjmë thirrje:

- Të gjithëve — individëve, kolektivëve, sindikatave, shoqatave, organizatave të bëjnë gjithçka që është e mundur për të thyer operacionin e represionit dhe dëbimit të Prosfigjikës.
- Të gjithëve individëve, kolektivëve, strukturave, iniciativave të qëndrojnë përkrah ose të vijnë të jetojnë në Prosfigjika.
- Të gjithëve të qëndrojnë vigjilentë ndaj provokimeve të mundshme nga shteti dhe policia, të cilat do të përpiqen të përçajnë dhe të thyejnë Komunitetin dhe luftën tonë të përbashkët.

JO PROSFYGIKA PËR MITSOTAKISIN DHE KOMPANITË E TIJ – PROSFYGIKA TË REZISTENCËS SHOQËRORE, VETË-ORGANIZIMIT, BARAZISË DHE SOLIDARITETIT

ASNJË EURO NGA PARATË PUBLIKE PËR “RIZHVILLIMIN” E PROSFYGIKËS

PËRGJEGJËSI E PLOTË TEK KOMUNITETI – VETË-FINANCIM DHE VETË-ORGANIZIM

DUART LARG PROSFYGIKA

DO FITOJMË, OSE DO FITOJMË

Ju ftojme në një Asamble të Hapur Solidariteti me Komunitetin e Prosfigjika, për një informim të detajuar mbi situatën aktuale dhe planin e mbrojtjes së lagjes dhe të Komunitetit.

E diel, 8/2, ora 17:00,

**në Qendrën Sociale të Komunitetit të Prosfigjika,
rruga Degleri dhe Bulevardi Alexandras.**



Asambleja e Prosfigjikas

Mail: sykapro_squat@riseup.net

Blog: sykaprosquat.noblogs.org

Instagram: @sykapro

Twitter: @Prosfigjika